



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Legjislacion

Mbledhja nr. 30

Prishtinë, më 12 dhjetor 2011, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N- 302

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion

Në mbledhje morën pjesë: Arben Gashi – kryetar, Behar Selimi, Ardian Gjini, Albulena Haxhiu, Armend Zemaj, Amir Ahmeti dhe Jasmina Zhivković.

Munguan: Halit Krasniqi, Mufera Şinik, Arsim Bajrami dhe Haki Demolli.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Ermal Panduri – Radio Dukagjini, Edon Myftari – këshilltar Ligjor – NDI, Artan Canhasi – EULEX, Arta Avdiu – KTV,Gojani – Koha Ditore, Astrit Hoti – KGJK, Sanije Berisha OSBE, Florie Mehmeti – KDI, Natyra Krasniqi dhe Fixhrije Dragaj – praktikante.

Nga stafi i Komisionit për Legjislacion: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Arben Gashi, kryetar i Komisionit.

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i Procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 24.10 dhe 16.11. 2011;
3. Shqyrtimi i propozimeve për anëtarë të Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
4. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-72 për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror;
5. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin për Agjencinë e Kosovës për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguria bërthamore nr. 04/1120/L-67/1;
6. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-75 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 2003/24 për sport;
7. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-46 për transmetimin publik në Kosovë;
8. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari propozoi që pika e shtatë të hiqet nga rendi ditës.

Rendi ditës u miratua me ndryshimet e propozuara.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 24.10 dhe 16.11. 2011

Kryetari konstatoi se Komisioni i miratoi procesverbalet nga mbledhjet e mbajtura më 24.10 dhe 16.11.2011, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i propozimeve për anëtarë të Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Kryetari- Në fjalën e tij tha se me çështjen e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ka 10 muaj që po merremi prej se është formuar Komisioni, siç duket, kësaj çështjeje tashmë i ka ardhur fundi. I keni propozimet që kanë ardhur nga radhët e komuniteteve dhe një propozim nga radhët e komunitetit shqiptar. Propozime tjera nuk ka, kanë pasur mundësi edhe grupet tjera të propozojnë, një kërkesë ka qenë që mundësisht të kihet parasysh, që përfaqësuesi i cili vjen nga radhët e shqiptareve, të vijë nga gjykatat e qarkut, sepse gjykatat e qarkut nuk janë të përfaqësuara në Këshillin Gjyqësor të Kosovës, kështu që është marrë parasysh ky propozim, pasi që propozime tjera nuk kemi.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri u pajtua që Kuvendit t'ia paraqesë këtë

R e k o m a n d i m

Të emërohen anëtarë të Këshillit Gjyqësor të Kosovës këta kandidatë:

1. Raime Rama - Elezi – gjyqtare e Gjykatës së Qarkut në Prizren,
2. Nebojsha Boriçiç – gjyqtar i Gjykatës Supreme të Kosovës,
3. Salih Mekaj – kryetar i Gjykatës së Qarkut në Pejë.

4. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-72 për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror

U shqyrtua raporti me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetërorë dhe nuk u paraqitën vërejtje nga anëtarët e Komisionit.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri nxori këtë

Përfundim

1. Projektligji nr. 04/L-72 për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetërorë, e ka bazën juridike në nenin 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
2. Amendamentet e propozuara nga Komisionit FunkSIONAL e kanë bazën juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

3. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

5. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin për Agjencinë e Kosovës për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguria Bërthamore nr. 04/1120/L-67/1

U shqyrtua raporti me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin për Agjencinë e Kosovës për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguria Bërthamore dhe nuk u paraqitën vërejtje nga anëtarët e Komisionit.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri nxori këtë

Përfundim

1. Projektligji nr. 04/1120/L-67/1 për Agjencinë e Kosovës për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguria Bërthamore, e ka bazën juridike në nenin 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
 2. Amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL e kanë bazën juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.
 3. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.
- 5. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-75 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 2003/24 për sport**

U shqyrtua raporti me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-75 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 2003/24 për sport, dhe nuk u paraqitën vërejtje nga anëtarët e Komisionit.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri nxori këtë

Përfundim

1. Projektligji nr. 04/L-75 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 2003/24 për sport, e ka bazën juridike në nenin 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
2. Amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL e kanë bazën juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.
3. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL, mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

8. Të ndryshme

Albulena Haxhiu- Tha se kam një kërkesë, nëse ne si Komision mund t'ia adresojmë Kryesisë, dhe nëse kemi këtë javë seancë, të mos jetë si pikë e rendit të ditës projekt-kodi penal, për shkak se unë kam kërkuar nga Ministria e Drejtësisë që të ma dërgojë draftin e parë që është punuar nga ekspertët vendorë, për të bërë disa krahasime.

Kryetari- Sqaroi se në mbledhjen kur është miratuar në parim projekt-kodi penal, znj. Haxhiu nuk ka qenë prezentë, mirëpo Komisioni ka marrë vendim dhe e ka përkrahur në parim. Mirëpo, nëse e shohim të arsyeshme për afat shtesë, si grup parlamentar, jeni të përfaqësuar në Kryesi dhe mund të kërkonit që të mos radhitet edhe për një javë si pikë e rendit të ditës, por si Komision kemi marrë vendim dhe e kemi përkrahur.

Behar Selimi- U pajtua me parafolësin, meqenëse është aprovuar një here, është fjala për miratim në parim, nuk humbim asgjë. Ne e kemi në procedurë dhe kemi gati gjithë muajin dhjetor dhe janar, sepse nuk besoj që do të jetë gati deri në muajin shkurt. Prandaj, mundësia për të dhënë kontributin tonë do të na jepet pas aprovimit në parim në Kuvend, përndryshe do të politizohet pa nevojë, unë nuk jam dakord që t'i drejtohem Kryesisë.

Albulena Haxhiu- Në fjalën e saj të serishme, tha se unë pata vetëm një kërkesë, nuk thashë që të marrim vendim. Kështu ka ndodhur edhe me Ligjin për marrëdhëniet e detyrimeve, para se të shqyrtohej në parim në Komision, ka pasur 4 ditë që ka ardhur në kuti postare. E njëjta vlen edhe me projekt-kodin penal, janë dy projektligje që nuk bën t'i kalojmë pa i marrë të gjitha vërejtjet dhe të gjitha sugjerimet, sepse kur është shqyrtuar projektligji në Kuvend, asnjëri prej jush nuk ka pasur vërejtje përmbajtjesore, përveç meje. Andaj kërkoja që t'i drejtohem Kryesisë me kërkesë.

Kryetari- Duke u ndërlidhur me diskutimin e parafolësës, tha se sa për sqarim lidhur me Projektligjin për marrëdhëniet e detyrimeve, besoj se e dini që e kemi shtyrë më shumë se tri javë, nuk e kemi miratuar në parim në Komision sepse ka qenë ligj shumë voluminoz dhe për këtë ju është dhënë afat që të keni mundësi ta lexoni.

Mbledhja përfundoi në orën 12:45.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Arben Gashi